



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 03.03.2025
Numër Protokolli: 1605/2025

A.nr.134/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.134/2025 të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, L.V., kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.134/2025 të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, L.V.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, L.V.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 17.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 346/2025, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.134/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit me numër reference RN00015132, të shpallur me datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, për pozitën e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, ***sepse:***

Nga provat e administruara të lëndës rezultojnë se Inspektorati i Punës, më datë 13.09.2024 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00015132, për njëzet e një (21) pozitë të punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.09.2024 deri më 13.10.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezultojnë se në këtë konkurs kanë aplikuar 487 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 278 kandidatë, rrjedhimisht nga këto shkresa rezultojnë se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili sipas Vendimit të datës 21.10.2024, të Njësisë së Burimeve Njerëzore, është njoftuar se aplikacioni i tij është refuzuar ngase ka

bashkangjitur diplomën e pa nostrifikuar të fituar jashtë Republikës së Kosovës, duke mos plotësuar kështu kushtet e konkursit për të kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, më datë 24.12.2024 ka publikuar Njoftimin me numër protokollit 3374, për shpalljen e kandidatëve fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati K.S me gjithsejtë 96.8 pikë të arritura, kandidatja U.K-H me gjithsejtë 91.4 pikë të arritura, kandidatja D.I me gjithsejtë 90.4 pikë të arritura, kandidatja H.Th me gjithsejtë 82 pikë të arritura, kandidatja S.M me gjithsejtë 78.8 pikë të arritura, kandidatja M.T me gjithsejtë 78.4 pikë të arritura, kandidati A.F me gjithsejtë 78.2 pikë të arritura, kandidatja V.M-R me gjithsejtë 77.6 pikë të arritura, kandidati I.F me gjithsejtë 76.4 pikë të arritura, kandidatja Sh.K me gjithsejtë 76 pikë të arritura, kandidatja V.B me gjithsejtë 74.2 pikë të arritura, kandidatja V.S-L me gjithsejtë 73.6 pikë të arritura, kandidatja B.S me gjithsejtë 73 pikë të arritura, kandidati M.A me gjithsejtë 72.4 pikë të arritura si dhe kandidati F.Sh me gjithsejtë 72.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë fitues për njëzet e një (21) pozitat e punës *Inspektor i Punës* pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi i datës 21.10.2021 mbi të cilin i është refuzuar aplikacioni i punësimit për pozitën përkatëse është nxjerrë mbi konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, trajtimit të pabarabartë të kandidatëve/diskriminim dhe shkeljeve, duke theksuar ndër të tjera se për konkursin e njëjtë në Rajonin e Gjilanit me të njëjta dokumente i ka plotësuar kriteret e konkursit, si rrjedhojë i njëjti kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin e konkursit.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankesë është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.2124/2024 të datës 28.02.2025, me të cilin vendim është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015132, për njëzet e një (21) pozitat e punës *Inspektor i Punës* pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prishtinës, i shpallur më datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.2124/2024 të datës 28.02.2025 është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015132, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankesë është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.***

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.134/2025, të datës 17.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.134/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, L.V.;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*